



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
***Kuvendi - Skupština - Assembly***

---

**Legjislatura VIII**

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,  
Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen  
e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 108

Prishtinë, më 30.4.2024, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla 506

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Adnan Rrustemi, Driton Selmanaj, Artan Abrashi, Dimal Basha, Arijeta Rexhepi, Erxhan Galushi dhe Besnik Tahiri.

**Munguan:** Blerta Deliu-Kodra, Hajdar Beqa dhe Hydajet Hyseni-Kaloshi.

**Mbledhjen e kryesoi** Adnan Rrustemi, kryetar i Komisionit.

**Te ftuar dhe pjesëmarrës tjerë:** Alban Bislimi, Ekonomia Online; Valmir Gallopeni, Radio Dukagjini; Valmire Abdullahu, Ekonomia Online; Riard Bllaca, T7; Ngadhujim Halilaj, NDI; Arbër Thaçi, KDI; Loresa Kadrijaj, UBT; Eronë Shala, UBT; Xhenisa Osmani, UBT; Valon Ismaili, UBT; Naim Jaka, IKD; Agnesa Haxhiu, Kabineti; Blerina Istrefi, GLPS; Marigona Brahimi, KOHA; Benita Zeneli, ATV.

**Stafi mbështetës i Komisionit:** Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Draft-Kodit të sjelljes së deputetëve të Republikës së Kosovës;
3. Të ndryshme;

**1. Miratimi i rendit të ditës**

*Kryetari konstatoi se rendi i ditës u miratua pa me ndryshime.*

## 2. Shqyrtimi i Draft-Kodit të sjelljes së deputetëve të Republikës së Kosovës;

**Kryetari**, paraqiti për shqyrtim Draft-Kodin e Sjelljes së deputetëve të Republikës së Kosovës dhe tha se Komisioni për Legjislacion ka formuar një grup të punës, i cili ka hartuar procedurat për Kodin e sjelljes së deputetëve të Kuvendit të Kosovës dhe ky obligim rrjedh nga rregullorja e re e Kuvendit të Kosovës, e miratuar në fillim të kësaj legjislaturës dhe aty shprehet qartë me një nen të veçantë, që përcakton rregullat e sjelljes për deputetët e Kuvendit të Kosovës në seancë plenare, në mbledhje të komisioneve dhe në mjediset e Kuvendit, si në mjediset jashtë Kuvendit, përcakton dhe lartëson modelin e deputetit të përgjegjshëm, llogaridhënës, përfaqësues dhe që menaxhon ose shfrytëzon pasuritë publike të Kuvendit të Kosovës, përcakton edhe ndalesa për deputetët e Kuvendit të Kosovës që në seancë plenare, po ashtu, edhe në mbledhjet e komisioneve si dhe përcakton masat ndëshkuese për deputetët që nuk respektojnë apo shkelin Kodin e sjelljes. Kodi po ashtu, parasheh themelimin e një trupe të veçantë që do të trajtojë secilin rast që paraqitet me pretendimin për mosrespektimin e Kodit të sjelljes, e i cili do të marrë vendime me objektivitet, me transparencë dhe me profesionalizëm.

**Besnik Tahiri**, tha se ky takim i Komisionit për Legjislacion ka një rendësi të veçantë për shkak se është mbledhur që të miratojë një dokument, respektivisht një Kod të sjelljes së deputetëve, i cili nuk ka ekzistuar deri tani dhe pas miratimit të Rregullores së Punës së Kuvendit, miratimi i Kodit të sjelljes së deputetëve të Republikës së Kosovës padyshim është një akt, i cili do të ndihmojë jo vetëm funksionimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, mirëpo, do të krijojë obligime dhe do të themelojë një organ të ri, i cili ka një rëndësi të jashtëzakonshme. Po ashtu, tha se dëshiron të shpreh vlerësimin që ka për anëtarët e Komisionit për Legjislacion, që gjatë gjithë kohës kanë pasur një diskutim dhe kanë dhënë një kontribut dhe prej të cilëve sot e kemi një dokument, i cili është këtu para nesh për miratim. Njëkohësisht pati vlerësim të lartë për Institutin Demokratik Amerikan NDI, i cili gjatë gjithë kohës ka qenë me ne në trajtimin dhe diskutimin dhe me mbështetjen që e kemi marrë në punën tonë gjatë këtyre muajve. Kodi i Sjelljes i Kuvendit të Republikës së Kosovës është i shkurtër, mirëpo në esencë është një mjet pune, ku përcaktohen shumë saktësisht detyrimet, fushëveprimi, qëllimi, mirëpo edhe themelimi i një organi të ri të këtij institucioni, që ne po e themelojmë në Kuvendin e Kosovës. Kodi përcakton rregullat dhe standardet etike të deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës gjatë ushtrimit të funksionimit të Kuvendit të Kosovës. Më tej, tha se të gjitha parimet që janë ndërtuar, janë parime të cilat burojnë edhe nga dokumente nga institucionet më demokratike, duke i përfshirë edhe Kongresin Amerikan, ku kemi qenë për vizitë dhe shumë prej praktikave të cilat janë të aplikueshme në Kosovë, i kemi përfshirë në këtë dokument, duke e trajtuar me kujdes të madh interesin publik, për të cilin deputetët duhet të udhëhiqen nga parimet e ndershmërisë, objektivitetit, transparencës dhe llogaridhënies, pastaj shmangies së konfliktit të interesit, të respektimit të kolegëve pa dallim, promovimin e kulturës dhe etikës në Kuvend dhe gjithsesi krijimin e mekanizmave sanksionues, në qofte se është e kundërta. Kemi

qenë të drejtpërdrejtë të saktësojmë në nenin 5, ngacmimi seksual dhe të caktojmë saktësisht sjelljen e deputetëve dhe mënyrën se si duhet të trajtojmë këtë temë dhe si t'i përmbahemi dhe pastaj mos keqpërdorimin, respektivisht përdorimin e punimeve dhe stafit me një dispozitë të veçantë për fondet publike, çështjet e konflikteve të interesit dhe deklarimit të kontrollit të interesave, megjithëse kjo çështje është e rregulluar me disa ligje të tjera, mirëpo, e kemi saktësuar edhe këtu. Mospërputhshmëria në mes funksionimit të deputetit me aktivitetet tjera, deklarimi i pasurisë dhe dhuratave dhe tek neni 11, kemi vendosur rregullat e sjelljes në Kuvend, kodin e veshjes, paraqitjen e deputetit në veprimtarinë parlamentare, transparencën si dhe ruajtjen e informacionit të klasifikuar, në raste të caktuara, kur është në interes kombëtar. Ndërsa, tek neni 17, është përcaktuar shkelja e Kodit të Sjelljes, se cila është shkelje e lehtë dhe cila është shkelje e rëndë dhe cili është organi i cili do të bëjë zbatimin e Kodit të Sjelljes, duke themeluar edhe Këshillin Etik, ku është përcaktuar përbërja dhe funksionimi i këtij institucioni. Në fund, tha se si kryesues i këtij grupi të punës, është shumë e rëndësishme që ky Kod të ketë mbështetjen e të gjitha subjekteve politike.

**Kryetari**, tha se e vlerëson punën që ka bërë grupi i punës dhe po ashtu, falënderon NDI-në për mbështetjen e vazhdueshme që i ka dhënë Komisionit dhe grupit të punës për hartimin e këtij drafti, por edhe njohjen me praktikën e vendeve të ndryshme, mbi atë se si rregullohet sjellja e deputetëve në institucionet përfaqësuese.

**Dimal Basha**, tha se falënderon të gjithë deputetët që kanë qenë pjesë e grupit të punës dhe NDI-në për mbështetjen. Po ashtu, tha se edhe pse nuk ka qenë në grup të punës ka marrë shënime dhe ka lexuar Kodin, ku i ka edhe disa vërejtje të cilat mendon që duhet të merren parasysh para se të shkojë në miratim sepse siç dihet kjo kalon në një lexim të vetëm. Vërejtja e parë është tek neni 8, paragrafi 3 i Kodit “Deputeti nuk mund të ushtrojë në mënyrë aktive të drejtën e administrimit të ndonjë ndërmarrjeje nga fusha e veprimtarisë së tij” dhe shtoi se këtë dispozitë e gjejmë edhe në ligj duke propozuar që të fshihet. Kjo është praktikë edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Po ashtu, tha se edhe në delegacionin e Çekisë ku një deputet çek ishte pronar i një kompanie të armëve dhe në kemi parë mundësitë e një bashkëpunimi për një investim të tillë në Kosovë. Deputeti Basha theksoi se mendon që ka nën që rregullon atë se deputeti nuk mund të ushtrojë veprimtari që janë konflikt interesi i tij, pra nuk mund të marrin vendime apo të përfshihen në vendime të Kuvendit, që ndikojnë në biznesin e tij, por që nuk mendon që në ligj është gabim, ne duhet të përsërisim gabimin përmes Kodit të Etikës. Propozimi i dytë është neni 15, i Kodit, ku përmendët “trajnimi i deputetëve”, por mendoj që deputetët nuk trajnohen, por është më shumë si “ditë orientuese” që administrata e organizon për deputetët e rinj. Si propozim është që pas paragrafi 1, të nenit 15 të Kodit “Te amnistohet, angazhohet të organizojë dy ditë orientuese për njoftimin dhe këshillimin e deputetëve të rinj”, paragrafi 2 “Ditët orientuese të përbëhen prej tre komponentëve, këto ditë orientuese organizohen nga administrata e Kuvendit dhe organizatat profesionale” dhe paragrafi 3 të fshihet tërësisht, për shkak se përfshihet tek paragrafi 1 dhe tek paragrafi 5” Deputeti pasi që të

veprojë për një çështje etike, ku është ndryshim për rrjedhën e veprimit të kryer të tij ose të saj, mund të konsultohet me Këshillin për Etikë. Gjithashtu, shtoi se tek neni 21 i Kodit, Këshilli përbëhet prej tre anëtarëve kryesues dhe dy janë prej komuniteteve dhe prej 9 anëtarëve, kur i kemi 2 nga komunitetet, kjo përbën 22% të përbërjes së këshillit dhe Kosova nuk i ka 22% komunitete dhe vazhdojnë të vijnë kritika që në Kosovë ka problem, ndërsa qasja afirmative që e kanë deputetët me komunitetet është për lëvdatë, mirëpo, të kemi dy anëtarë të komuniteteve që përbëjnë 22%, ndërsa popullsinë nuk e kanë as në Republikë as në Kuvend dhe shtoi se ky është një plus i madh për qasjen që e kanë deputetët, pa presionin e askujt, ku i përfshijnë komunitetet më shumë se që kanë popullsi. Ndërsa, tek neni 25, paragrafi 6 propozoi të shtohet në fund të paragrafit “ mund t’i mbajë takimet edhe online”

Nëse vlerëson dhe vendos këshilli mund të mbahet mbledhja online dhe të merret vendimi në të njëjtën kohë, për arsye praktike duhet të kemi parasysh rrethanat e jashtëzakonshme, si p.sh. të pandemisë ‘covid 19’ të mbetet si mundësi. Tek neni 26 masat ndëshkuese për deputet janë suspendimi dhe ne rast të shkeljes së rëndë të përsëritur deputetes apo deputetit i shqiptohet vërejtje me shpallje publike në ueb faqen e Kuvendit dhe deklarimin e shkeljes në seancën e ardhshme të Kuvendit, suspendimi nga pjesëmarrja, deri tek seanca plenare, varësisht nga niveli i shkeljes së Kodit, suspendimi nga pjesëmarrja deri në tre herë në mbledhjet e komisioneve, varësisht nga niveli i shkeljes së Kodit. Ndër të tjera, tha se qasja është e gabueshme për arsye sepse nëse e dënojmë deputetin me mospjesëmarrje në seanca, apo në komisione, këtu po dënohet qytetari jo deputeti për mos sjelljen e tij për shkak se deputeti nuk vjen të votojë ligje dhe nëse ja pamundësojmë votimin e ligjeve i mohohet e drejta. Pra, nëse dëshirojmë të dënojmë deputetin, duhet të konsiderojmë sanksionet financiare dhe tek sanksionet financiare është përfshirë deri në 20% të pagës dhe tha, se mendon që kjo është shumë e ulët dhe nëse dëshirojmë t’i dënojmë, po i dënojmë vetëm deputetët për sjelljen e tij/saj dhe e bëjmë deri në tre paga. Më tej tha, se i duket e paarsyeshme që t’i themi deputetit të mos vij në tre seanca, marrë parasysh që seancat nuk paguhen dhe nuk shoh ndonjë dënim këtu. Propozoi që sanksioni mos të jetë 20%, por deri në tre paga sepse nuk duket dënim i arsyeshëm nëse e dënojmë me mospjesëmarrje në seancë, apo në mbledhje të komisioneve sepse me këtë po e dënojmë qytetarin dhe jo deputetin.

**Driton Selmanaj**, tha se po e diskutojmë një dokument të rëndësishëm dhe për herë të parë po tentohet të aplikohet një formë të re të ndëshkimit të deputetëve sepse deri më sot nuk ka pasur dokument që ka përcaktuar për masat për sjelljet e pahijshme të deputetëve. Po ashtu, tha se si grup pune me mbështetje të NDI-së i kanë trajtuar me kujdes propozimet duke dhënë kontributin në draftimin e këtij dokumenti dhe se sot duket pak vonë për disa çështje që i ngriti deputeti Basha me të drejtë, por megjithatë më shumë se një vit është punuar në këtë dokument, të cilat janë trajtuar të gjitha në hollësi. Më tej, tha se ka përshtypjen që po hapen tema që i kanë diskutuar me orë dhe ditë të tëra. Mund të mos pajtohem në parim që deputetëve të mos ju lejohet të udhëheqin një biznes apo ndërmarrje, por megjithatë këto janë rregullat që i kemi vendosur ne si shoqëri deri tash dhe këto çështje janë të rregulluara me ligj. Nëse hiqet paragrafi

3 duhet të hiqet edhe paragrafi 2, sepse nuk lejohet të punësohesh as si këshilltar në një ndërmarrje, prandaj nuk mundemi sot të hyjmë në aventura të tilla, meqenëse këto çështje janë të rregulluara me ligj dhe kur të ndryshohen ligjet e caktuara ndërrohet edhe Kodi, po nuk mund të largojmë çështje për të cilat ne jemi përcaktuar dhe i kemi vendosur si shoqëri. Mendoj se kjo duhet të rishikohet, sidomos tek njerëzit që janë të zot në fushën e biznesit dhe ndërmarrësisë, mirëpo, ua ndalon që të merren me politike sepse pastaj duhet t'u hyjmë matematikave improvizuese për t'ia s'postua firmën motrës apo vëllait të dikujt vetëm sa për improvizim dhe tha se është mirë që këto gjëra t'i tejkalojmë. Ndërsa, në çështjet tjera që deputeti Basha i ngriti, si prania fizike e anëtarëve të këshillit, në momentin kur mblidhen, tha se gjithmonë ka funksion për respektimin e afateve, pra nëse brenda afateve që kemi përcaktuar nuk ka mundësi të gjejmë mënyrë të mblidhen deputetët sepse nuk janë në Kosovë, mund ta mendojmë këtë, ndërsa, në rastet tjera asnjëherë nuk do të kisha menduar të diskutojmë për sjelljen e pahijshme të një deputeti, të lidhet me Skype ose online. Ne këtë Kod trajtohen shumë çështje që rregullohen edhe me dokumente tjera, si në Rregulloren e Punës së Kuvendit, me ligjin për parandalimin e konfliktit të interesit, të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit, por ne kemi shprehur një qasje afirmative që vërtetë të kemi një përpjekje që të tregojmë që jemi model i shoqërisë dhe i politikanëve që sjellin brenda Kuvendit të Kosovës, si në gjuhë, si në veshje, në sjellje ndaj kolegëve/kolegeve dhe stafit të administratës. Pas këtij dokumenti, brenda gjashtë muajve do të nxjerrim një udhëzues të hollësishëm, i cili përcakton edhe shumë çështje për të cilat ne nuk kemi mundur t'i përfshijmë në këtë Kod sepse kemi pasur vështirësi të përcaktojmë se çfarë është veshje zyrtare, a mund të lejohet në Kuvendin e Kosovës të futet me rroba sportive apo me veshje të papranueshme që mund të kem elemente jo të mira dhe të hijshme për sy. Në të gjitha vendet demokratike që kemi vizituar në institucionet e tilla, si Kuvendi duhet të ketë një kod të veshjes, madje jo vetëm për deputetët duhet të ketë edhe për pjesëmarrës të tjerë edhe për vizitorët. Në parim, ne duhet ta mbështesim sot këtë dokument, jo vetëm si dokument, por ta instalojmë si kulturë të sjelljes dhe ta shohim përgjatë ditëve në vijim, kur të fillojmë zbatimin e tij për të parë se ku jemi. Ndërkaq, tha se nuk e sheh si problem përfaqësimin e pakicave sepse edhe në Kushtetutë është afirmative dhe se nuk kemi zgjidhje tjetër përveç se t'i përfshijmë kështu ose duhet t'i bëjmë pakicat pjesë e numrit të deputetëve, nga shumica parlamentare dhe këtë e kemi diskutuar gjatë edhe me kryetarin që nuk është pajtuar sepse zakonisht edhe në Kushtetutë pakicat janë pjesë e qeverisjes.

**Kryetari**, tha se është e vërtetë që në këtë grup të punës është punuar intensivisht dhe jemi përpjekur që të konsultohemi edhe me grupet parlamentare për të sjellë komentet. E vërteta është se dokumente të tilla sistematike ndryshimet do ishte mirë të ishin në raport me diskutimet që kanë ndodhur në vazhdimësi. Tha, se pajtohet me disa nga sugjerimet e deputetit Basha, por për disa tjera tha se mendon që nuk duhet të ndryshohen. Në neni 8, në tërësi “mospërputhshmëria e funksionit të deputetit me aktivitetet tjera” vlen të ceket se neni është marrë nga Ligji për deputetët dhe mund të kemi qëndrime të ndryshme mbi atë se a është e drejtë apo e zbatueshme, mirëpo, për sa kohë që është ligji në fuqi edhe po e hoqëm nga Kodi

detyrimi do të mbetet për deputet dhe po të ketë ndryshime në ligj atëherë do të bëhet edhe ndryshimi i Kodit sepse është dokument që miratohet me shumicë të thjeshtë të deputetëve. Po ashtu, tha se tek kërkesa për ditët e orientimit pajtohet edhe tek kërkesa për mbledhje online pajtohet mbi bazën e asaj që potencoi deputeti Selmanaj, nëse bëhet e pamundur që anëtarët e Këshillit nuk janë në Kosove, ndërkohë që afatet konsumohen duhet të japin mundësinë e mbledhjes online ose të kombinimit të mbledhjes disa në mbledhje fizikisht e disa të lidhen online për të mundësuar efikasitet. Sa i përket masave, mendon që nuk është çështja vetëm tek ndëshkimi i deputetit është edhe ndëshkimi i grupit parlamentar që e përfaqëson në kuptimin e vështirësisë për funksionim, apo vendimmarrje sepse nëse përjashtohet deputeti nga komisioni për tre mbledhje e ndikon të gjithë grupin parlamentar dhe kjo shërben si presion për deputetin në fjalë që të ketë sjellje parlamentare me kolegët. Më tej, tha se është e vërtetë që deputetët kanë mandat të lirë, por në sistemin tonë zgjedhor në masë të madhe janë pjesë e grupeve parlamentare të subjekteve politike, që kanë garuar me një listë dhe kanë marrë votat me një cikël politik. Ndërkaq, shtoi se ndëshkimi do të jetë pak edhe për strukturën, jo vetëm për individin, andaj jemi përpjekur të kombinojmë masa të tilla të cilat e përfshijnë edhe sanksionimin me ndalim pjesëmarrje në seanca, por edhe sanksioni financiar. Gjithashtu, tha se është dakord që të rritet sanksioni financiar që është 20%, mund të bëhet 30% ose edhe deri në 50% të pagës sepse ka qenë edhe propozuesi rritjes së kësaj mase sepse ka qenë më e vogël, shumë simbolike, por i mbetet këtij këshilli në varësi të shkeljes të marrë vendimin se a duhet përjashtim nga seanca deri në tre mbledhje, apo duhet ndëshkim financiar apo të dyja njëkohësisht.

**Driton Selmanaj**, tha se mund të përfshijmë edhe çështje që dalin mirë në opinion, mirëpo ideja është se a mund t'i zbatohet ato sepse mund të themi gjashtë rroga ja heqim deputetit, por a mund ta zbatohet atë dhe mos të harrojmë se për herë të parë në një dokument po vendosen masa sanksionuese financiare ndaj deputetit. Po ashtu, tha se ka dilema nëse dikush e dërgon këtë në Gjykatën Kushtetuese se a është kushtetuese apo jo. Kushtetuta i jep liri dhe pavarësi të plotë deputetit dhe i përgjigjet vetëm zgjedhësve të tij askujt tjetër ndërsa masat sanksionuese, masat ndëshkuese ndaj deputetit janë këto, por ne kemi dashur që të përmirësojmë imazhin, sjelljet dhe të provojmë të eliminojmë çfarëdo dukurie eventuale negative që mund të ketë brenda këtij institucioni. Gjithashtu, tha se mendon që deri në 20% të pagës bazë ta ndëshkojmë deputetin është e mjaftueshme dhe se është çështje tjetër se si do të aplikohet kjo dhe duhet ta zbërthejmë në udhëzuesin në detaje, se a kemi të drejtë t'i ndalojmë një page apo jo, mirëpo, shtoi se mendon që në fakt është masë bukur e rëndë, por të mendohet heqja e dy rrogave, ne mund t'i bëjmë, por nuk mund të zbatohen. Këto masa që i kemi vendosur janë marrë nga praktikat e vendeve tjera dhe është masë bukur e rëndë, të mos lejohet deputeti të hyjë në seancë apo në tre mbledhje të komisioneve dhe ky ndëshkim merr jehonë pastaj si rezultat i sjelljes të keqe të deputetit, qoftë ndaj stafit, apo ndaj kolegëve, qoftë ndaj gjuhës parlamentare, qoftë ndaj dhunës fizike dhe shtoi se është e mjaftueshme si masë ndëshkuese dhe se duhet të mbetet

kështu. Në fund tha se ky Kod etik do të ketë efekt jo vetëm politik, por nënkupton për moshën edhe sjelljen morale, pra po preket etika e njerëzve.

**Besnik Tahiri**, potencoi se ajo që kemi parë prej punës gjatë hartimit të Kodit, është së pari fakti që kurrë në asnjë institucion nuk është statik. Tek Kongresi, Kodi etik ishte formuar në vitin 1967, pastaj gjatë kohës ka pësuar ndryshime rrënjësore në bazë të zhvillimeve që kanë ndodhur, kur flasim tek shekulli i fundit, duke hyrë në funksion rrjetet sociale dhe duke hyrë në funksion komunikimi online, gjithmonë ka evoluar. Tek Këshilli i Evropës, më 12 shkurt të vitit 2021 është draftuar, me gjuhën, me çështje të ndryshme, prandaj dhe për këtë dokument e shoh shumë të vlefshme komentet që janë bërë. Sa i përket propozimit për nenin 8, tha se pajtohet plotësisht, mirëpo, këtu ne e kemi marrë dispozitën ligjore dhe ajo që mund të bëjmë është që kur të vij grupi i punës për ligjin për Kuvendin, do ta trajtojmë këtë temë prej kësaj perspektive, tek kërkesa për ditët e trajnimit është në rregull. Ajo që dëshirojmë t'i japim si kulturë organizative Kuvendit, me themelimin e organit të ri është ta rrisim përgjegjshmërinë e marrjes pjesë edhe të trajtimit të sanksionit tek shkeljet e lehta dhe të rënda. Po ashtu, tha se e kanë parë se si rregullohet çështja si në Kongres po ashtu edhe në Shqipëri dhe në vende të tjera dhe është problem trajtimi i kësaj teme, për shkak se këtu i kemi deputetët që do të jenë dhoma e lartë e gjykatësve që do të gjykojnë dhe në këtë nisje ne e kemi rregulluar më të moderuar sanksionimin dhe menaxhimin, në mënyrë të mundshme që mund të ndodhë.

Tek çështja e pakicave këtë e kemi pasur si diskutim dhe është shteti i vetëm që në fakt e ka shoqërinë 95% janë një etni, ndërsa e gjithë fryma kushtetuese dhe ligjet e veta i ka në koncept multi-etnik. Ndërsa, tek kërkesa e fundit është çështja e te drejtës së ankesës, ku mund të bie ndesh me ligjin e kontestit dhe kontrollit administrativ, nëse do e bartnim shkallën e dytë tek kryesia realisht do e minimizonim fuqinë e një komuniteti të fortë.

**Dimal Basha**, tha se tek neni 8, në parim po pajtohemi të gjithë që mos ta dublifikojmë dhe ta heqim tërësisht paragrafin vetëm pse ekziston si dispozitë në ligjin përkatës, nuk do të thotë se duhet ta vendosim edhe këtu, pra nëse pajtohemi që është gabim atje, përse ta vendosim këtu ndërsa e kemi pozitën të punojë si këshilltar dhe këtë mund ta diskutojmë. Ndërsa, tek neni 19, Gjithashtu, tha se tek sanksionimi propozoi që të nga pjesëmarrja deri në tri (3) seanca plenare dhe nga pjesëmarrja deri në tri (3) mbledhje të komisioneve. Pra, po dënohet grupi parlamentar, qytetari, por, nuk po dënohet deputeti duke pohuar se kultura e ndëshkimit duhet të jetë për personin dhe jo për të tjerët.

**Kryetari**, tha se deputetët mos t'i shohim si individë, por veprimi i tyre mund të jetë edhe në funksion të veprimit kolektiv të një grupi parlamentar dhe ndëshkimi në grup parlamentar është i madh nëse ja pamundëson zërin politik, qoftë në komision, apo edhe në seancë plenare. Ndër të tjera, tha se duhet të mbetet ndëshkimi me mospjesëmarrje, duke pohuar se ka vend për diskutim apo analizë paraprake, se a duhet të jetë 3 seanca rresht apo më shumë. Po ashtu, tha se pajtohet që sanksionet financiare në pagë të bëhet nga 20%, në 50% të pagës bazë.

**Besnik Tahiri**, tha se në lidhje me sanksionin financiar në pagë, kur kanë diskutuar ka qenë edhe më i ulët se 20%, por nuk e rregullon as personin që bën shkeljen, por as masën ndëshkuese ndaj propozoi që të nxirret në votim, kështu siç është në draft.

**Dimal Basha**, tha se është bërë një punë shumë e mirë nga grupi i punës dhe u pajtua që sanksionet të jenë në komision dhe në seancë plenare, deri në 50%.

**Driton Selmanaj**, tha se janë marrë vesh para tre muajve secili për ta diskutuar me grupet e veta parlamentare, për të paraqitur propozimet dhe si grup pune i diskutonim propozimet dhe jo të vihet me propozime të tilla pa asnjë ekspertizë minimale. Po ashtu, tha se me NDI-në kanë qenë në Kongresin Amerikan dhe në Shqipëri, për të marrë praktikën më të mira në lidhje me këtë draft. Askund në botë nuk i hiqet paga e deputetit për 3 muaj apo 4 muaj sepse kjo nuk është masë ndëshkuese por popullizëm. Kjo masë ndëshkuese është për sjellje që e bën deputeti gjatë punës së tij në Kuvend se për shkeljet apo veprimet tjera ai i përgjigjet dënimeve penale sepse nuk ka imunitet. Por, këtu po flitet për gjuhë joparlamentare dhe sjellje e pahijshme duke pohuar se nuk mund të dënohet me sanksione financiare, deri në tre rroga, ndaj është diskutim i kotë dhe pa informacione bazike se si e kanë nëpër vendet tjera.

**Dimal Basha**, tha se propozimi i tij i duket i arsyeshëm që sanksioni financiar të jetë deri në 50% të pagës bazë.

**Kryetari**, tha se nuk mund ti mohohet e drejta e deputetit të bëjë propozime në lidhje projektligjin apo me një çështje të caktuar. Po ashtu, tha se është e vërtetë që propozimet aty për aty, pa e përfshirë gjithë diskutimin dhe analizën mund ta ndryshojnë të tërë strukturën sepse tek neni 8 paragrafi 3, metodikisht nuk është në rregull të hiqet sepse ekziston në ligjin në fuqi. Pra, është i gjithë neni njësoj, si në ligj dhe si qasje nuk është në rregull të hiqet paragrafi 3 i nenit 8, por bie dakord të hiqet. Tek mbledhja online është dakord të shtohet, tek trajnimet është dakord të ndryshohet sipas propozimeve, tek përbërja e Këshillit mbetet siç është në draft, sepse e ruan raportin pozitë- opozitë dhe siguron përfaqësim të grupeve parlamentare, ndërsa tek ndëshkimi, tha se është dakord të mbetet deri në 50% dhe mos ti hiqen 3 paga, ashtu siç u propozua.

*Pas diskutimeve, kryetari konstatoi se anëtarët e komisionit me propozimet e paraqitura me 5 vota për dhe 1 votë abstenim vendosi, që Kuvendit t'ia paraqes këtë:*

## **R e k o m a n d i m**

Të miratohet Kodi i sjelljes për deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës



### **3. Të ndryshme**

Në këtë pikë nuk pati ndonjë çështje tjetër për diskutim.

Mbledhja përfundoi në orën 11:00.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

**Adnan Rustemi,**  
Kryetar i Komisionit

-----